

BOTIM

NGA BARDHYL DEMIRAJ

Vijon nga numri 1 shkuar

Le të përgjendrohem në vazhdim në secilën çështje:

4. 'Mungesa' të thepruara si dëshmi të shpëlarjes së kujtesës

Një mendje intelektuale sado e qetë ase e qetësuar do të shogëronte kumtin e mësipërm për periudhën prijëse, më shumë se pesëshekullore (v. 1400-1912) - goftë edhe në diskurs me vetveten - natyrshëm me pyetjen se: Mos vallë gjendemi vërtet e mirëfilli përballë një realiteti kulturor-historik sa të brishtë aq edhe të trishtë, por të siguar dhe firmosur vetëdijshëm me vullën e rëndë dhe pendën e lehtë të bordit drejtues të Enciklopedisë Shqiptare, veçse i cilluar tashmë prej atyre prangave ideologjike dhe dhunës strukturore të sistemit të dikurshëm shoqëror-politik (?), d.m.th. kemi të bëjmë vërtet me një realitet shqiptar më se pesëshekullor që emeton mirëfilli një trashëgimi kulturore-historike po-shqiptare po aq të brishtë e po aq të trishtë e me po aq pak bartës, madje një pjesë aspak e vogël syresh thuajse krejt rastësorë? Në këtë rast nuk na mbetet gjë tjetër, veçse të marrim fyellin e vjetër e t'i biem po në brimën e vjetër, duke i kënduar në vazhdimësi këngës po aq të vjetër, sipas së cilës ishte sundimi otoman pesëshekullor ai lugat e malukat që na rrëgoi e shoi me rrënjë e me degë çdo qelizë të jetës kulturore-intelektuale shqiptare në hapësirën jetike po-shqiptare në Ballkan, përpos atij shpirti gjithëherë luftarak e lirisdashës të popullit vetë, të udhëhequr sigurisht nga një tubë prijësash epikë, të cilët jo rrallë e për mall dhanë edhe jetën për liri dhe pavarësi.

Por jo vetëm kaq: Fati e solli të hynte në FESH I e - për rrjedhojë edhe - në FESH II pak dritë jeshile prej kolonive shqiptare në mërgim (të mos harrojmë as arvanitë e Greqisë dhe as arbëreshët e Italisë së Jugut dhe të Sicilisë!!!) me dëshmuar se ky popull kishte edhe aftësi komb- dhe shtetformuese, madje dinte të lëvronte sadopak edhe një kulturë të atillë diturake që i hapte vetiu dyert e salloneve njëjloj diturakë aty ku "dilelli lind, andej nga perëndon." (Naimi)

Parë nga ky këndvështrim, përkatësisht mbështetur në rezultatet e përjasjes së inventarit të zërave të personaliteteve në FESH I kundrejt FESH II, nuk kemi përse të ruajmë tash aspak distancë ndaj mëdyshjes sonë të parë e të kaluamë natyrshëm në përsiatjen paraprake, se mos ndoshta në platformën e FESH II - për këtë periudhë!!! - kemi të bëjmë thjeshtë vetëm me një fakt, që vjen me thënë me një akt-marrëveshje të heshtur ndaj atyre rezultateve të përcjella në FESH I, duke e konsideruar krehjen dhe klasifikimin e gjithë kësaj periudhe si një proces pak a shumë të mbyllur në të dhe prej tij, edhe pse sipas mundësive, përkatësisht aftësive e kompetencës profesionale të njërit apo tjetrit redaktor përgjegjës (në FESH II), ky inventar mund të plotësohej potencialisht sipas kohës dhe rastit me ndonjë garniturë shtesë e po aq të rastit.

Asgjëmangut, nuk bëjmë fjalë në këtë rast thjeshtë dhe vetëm për mungesa, harresa ase lajthitje apo shtesa të karakterit redaksional, të cilat sigurisht nuk rezultojnë të jenë aspak të paka si në sasi, ashtu edhe në cilësi, se sa për një bazë ideologjike dikur të mirë-studiuar lidhur me caqet dhe mënyrën e hetimit, përkatësisht të gjymtimit të trashëgimisë kulturore-historike të patundshme të popullit shqiptar në kohë e hapësirë, një bazë kjo që zuri rrënjë e hodhi shtat pa kurrfarë dyshimi në vitet e dhunës strukturore e të politikës vrastare ndaj kulturës dhe kërkimit shkencor

Shkruesi i këtyre radhëve e ka vërtet të vështirë të rrokë në mendje dhe zemër përmasat e kësaj ndeshtrashe ogurzezë, sidomos të zhbhiriljohë goftë edhe ato përjetime të para të njërit apo tjetrit intelektual, në mos koleg albanolog të gjallë - e këta janë (ende) shumë!!! - që ka pasur fatin të lexojë, në mos të redaktojë po vetë, lëvdatën e vet si fjalë të vet mortore ndaj personit të vet...

FJALORI ENCIKLOPEDIK SHQIPTAR

...dhe shpëlarja e kujtesës historike-intelektuale



Bardhyl Demiraj

albanologjik, duke arritur kështu natyrshëm një pikë kulmore bash me daljen në dritë të FESH I, e që për periudhën në fjalë gëzon në mënyrë të (pa)vetëdijshme miratim deri mirakandje, goftë edhe me re-tushimet e rastit, bash në platformën e FESH II.

Lejohe mi të fokusohemi tash për ilustrim sidomos në atë qëndrim redaksional, në mos parimor-ideologjik (!!!) në FESH I e - për rrjedhojë edhe - në FESH II ndaj institucionit të kultit, përkatësisht ndaj prurjeve me karakter kulturor-intelektual që ka përcjellë përgjithësisht ky institucion me variantet e ndryshme dhe veprimtarët e tij të shumtë në trashëgiminë historike-kulturore të popullit shqiptar. Goftë edhe për arsye vendi, por edhe - madje sidomos!!! - për shkak të diskriminimit deri në përcudnim historik-kulturor dhe fizik që ka vuajtur në vazhdimësi e deri diku i vuan ende sot e gjithë ditën, jemi rrekur të tematizojmë në këtë shkrim vetëm qëndrimin ndaj njërit prej varianteve më jetëgjatë të këtij institucioni ndër shqiptarë, bash sjelljen mizore ndaj Kishës Katolike-Romake dhe trashëgimisë së saj kulturore-historike, përkatësisht ndaj veprimit dhe ndikimit të saj kulturor-intelektual në Shqipërinë e Veriut. Bëjmë fjalë pra për një institucion që ka përjetuar e vuajtur gjatë dy periudhave në shqyrtim ndesh-trashat dhe zezonat e mëdha të moteve e që në një formë a një tjetër i përjeton pa ndonjë ndryshim të dukshëm edhe në botimin e dytë të FESH II, pas gjase falë atij pakti të heshtur e të (pa)vetëdijshëm si pjellë e pro-

cesit damnatio memoriae / shuarje e kujtesës që guxuaam ta përsiasim më lart.

Jemi më se të ndërgegjegjshëm që shumëkush mund të acarohet, madje rëndë, lidhur me këtë përsiatje të bërë në formë konstatimi, pastaj të pastrojë gurmazin e të grrret fort, duke u rrekur të na e shkulë gishtin nga plaga e të na tregojë se sa e sa (?) personalitete fetare në historinë e kulturës së shkrimit shqip gjatë asaj periudhe (v. 1400-1912) na shfaqen edhe në FESH I, të tilla si: Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani, Gjon Nikollë Kazazi e ndonjë tjetër, duke shpejtuar pastaj të shtojë edhe ndonjë zë rastësor në FESH II, si p.sh. ai i Zef Bubçit: "Famullitar i Shkodrës, që hartoi një kronikë latine për ngjarjet e v. 1831-1839." (shih shën. 10), ose ndonjë tjetër të transformuar rrënjësisht, si p.sh. zëri enciklopedik i At Gjergj Fishtës (FESH I, f. 270: klerik reaksionar vs. FESH II, f. 684v: klerik dhe poet kombëtar). Këto çirra sigurisht që nuk e kemi aspak të vështirë t'i qetësojmë e t'i shuajmë shpejt; mjafton të tumirim në këtë rast pa kurrfarë hezitimi atë ndjesi, së bashku me vetëdijen dhe aktivitetin social-intelektual të njërit apo tjetrit klerik atdhetar dhe lëvruar të shqipes si pjesëtar aktiv i asaj bashkësie dhe për atë bashkësi kulturore-etnike që përdorte brenda saj shqipesin si mjet komunikimi. Veçse të mos harrojmë e assesi të anashkalojmë faktin, që kemi të bëjmë në radhë të parë me syresh të krishterë të devotshëm që kishin përjetuar së gjalli 'Thirrjen Hyjnore', duke ngjizur kështu në mish e në shpirt besimin në Krishtin, dhe bash falë këtij besimi përcillnin me pendë në letër të bardhë bindjen ndaj ardhmërisë së bashkësisë shqiptare,

së cilës ishin po aq të vetëdijshëm se i takonin. Duke u nisur nga kjo perspektivë ne jemi sot në gjendje të zgjidhim lehtë, thuajse në mënyrë triviale, edhe atë të ashtuquajtur 'enigmë' që na ka lënë trashëgim biri i Bdekës në pasthënen e pëllesës së vet: "Tue kujtuom shumë herë qi gluha jonë nukët kish gj? të endigluome'n së Shkruomit Shenjtë, en së dashunit së Botësë sanë [= Shkrimi të Shenjtë ndër arbëneshë - B.D.], desha me u fëdigunë, për sa muja me ditunë, me zdrëitunë pak mendetë e atyne qi të endiglonjënë".

Pa dashur të zhbhiriljohë edhe në më shumë hollësi për ata të pakë klerikë të tjerë katolikë shqiptarë, emri dhe vepra e të cilëve ka gjetur gjithësi pasqyrim në të parin e - për rrjedhojë, goftë në mënyrë "të riformëzuar", edhe - në të dytin botim të FESH-it, lejohe mi të mëtojme pa gabuar aspak që në FESH I - e ky është vetëm njëri ndër mëkatet mortore të dhunës strukturore të kohës që përcjell ai botim (!!!) - feja dhe besimi fetar, institucionet e kultit dhe angazhimi i tyre kulturor-intelektual i janë transmëtuar lexuesit të çdo kategorie vetëm si "opium i popullit" (Karl Marks - mungon si zë i veçantë në FESH II), ndërko-hë që historia ekleziastike shqiptare, përkatësisht veprimi dhe prurjet kulturore-intelektuale të pjesëtarëve aktivë të institucioneve të kultit - në rastin tonë të Kishës Katolike-Romake - i janë ndaluar dhe fshehur sa vetëdijshëm e turpshëm aq edhe frikshëm e dhunshëm goftë studiuesve të fushës, ashtu edhe lexuesve, sado sqimatarë që mund a duhej të ishin. Shkruesi i këtyre radhëve e ka përjetuar këtë ndalesë të natyrës redaksionale, në mos edhe ideologjike, përkatësisht fshehje të vetëdijshme në formë shformëzimi për periudhën në fjalë (v. 1400 - 1912) në FESH I e - për rrjedhojë edhe - në FESH II në disa mënyra, të cilat lejohe mi t'i përcjellim thukët, sa vijon:


1) Nuk është marrë fare në konsideratë - e në FESH I s'kishte edhe si të merrej! - 'besimi fetar' si njëri ndër përberësit themelorë të matrisit të kulturës etnike shqiptare, përkatësisht është lënë me vetëdije në heshtje e tërë historia ekleziastike e Kishës Katolike në hapësirën jetike shqipfolëse, edhe pse kjo histori, si pjesë e natyrshme dhe thelbësore e trashëgimisë historike-kulturore shqiptare, të paktën për periudhën në fjalë mund të konsultohet e të qëmtohet më maës deri diku të kënaqshme në manualët enciklopedikë të kohës, sikurse në mënyrë edhe më të detajuar gjatë krehjes së një numri aspak të vogël relacionesh për viza të ndryshme apostolike ose syresh baritore të arqipeshkvijve e ipeshkvijve në Provincës Kishitare të Arbënisë e të Arqipeshkvisë së Shkupit, të cilat i dërgoheshin rregullisht çdo tre vjet Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-së në Romë.

2) Përfshirja e atyre pak klerikëve atdhetarë shqiptarë, disa prej të cilëve i përmendëm më lart, duket qartë se është bërë, si të thuash: në mos nga qejfi, të paktën nga halli, duke shformëzuar sa dhe si të ketë qenë e mundur funksionin dhe aktivitetin e tyre zanafilës, e kjo, pas gjase, jo vetëm sepse gëzonin historikisht autoritet e stimë të veçantë në rrethet intelektuale shqiptare të kohës, por edhe se vepra dhe trashëgimia e tyre ishin shndërruar me



Injoranca nuk njih sistem shoqëror

Injoranca nuk njih sistem shoqëror; ishte dikur regjimi politik me bazën e vet ideologjike në Shqipërinë e gjysmës së dytë të shek. XX që u rrek të orientonte njëanshëm formimin intelektual shqiptar, thjeshtë dhe vetëm me syzimin largvajtës për të krijuar njeriun e ri intelektual me injorancë të thellë e të pashembull kulturore-historike si bartës i një ideali të ri po aq injorues, sa të paudhë aq edhe dëshpakt ndaj jetës dhe historisë së kulturës shqiptare.



...nga numri i shkruar

Shkrimi kryesor i "Milosao"-s iu la gjuhëtarit Bardhyl Demiraj. Në fakt, një temë e nisur prej shumë kohësh dhe që do të vazhdojë me patjetër dhe në këtë numër. Është një ide që duket se e mundon dhe me kujdesin e vet, por nga ana tjetër edhe me paqurimin, ai ka mëturar se Fjalori Enciklopedik shqiptar është disi i dështuar. Në fakt, që në fillim, provokimi i tij është shumë interesant dhe sfida është e hapur : *Të duash të shfletosh botimin e dytë të Fjalor Enciklopedik Shqiptar (= FESH II, bl. I-III, Tiranë 2008/9) e për më tepër të konsultosh diçka në të që lidhet në një mënyrë a një tjetër me atë fushë ose ato fusha, në të cilat fiton bukën e gojës, duhet të jesh vërtet i regjuri me vaj e me uthull në jetën e sotme intelektuale shqiptare, e kjo jo thjesht dhe vetëm falë dhuntive të karakterit profesional, por*

kohë e ndërkohë në material burimor të dorës së parë për studime të mirëfillta diakronike në fushë të shqipes, të kulturës dhe të historisë shqiptare, të cilat nuk njihnin e nuk kishin si të njihnin më rubë nacionale.

Kështu nuk kemi përse bëjmë tash aspak çudi, që Imz. Pal Engjëlli (lat. <Paulus Angelus>), arqipeshkëv i Dioqezës Durrësit, bashkëkohës dhe këshilltar personal i Skënderbeut e organizator i Sinodit të njohur Dioqezan të Matit (1462), nuk gëzon aspak të drejtën të ketë një zë të veçantë në FESH I e - për rrjedhojë edhe - në FESH II, sic e gëzon "Formula e pagëzimit" (1462) si dëshmia e parë e një teksti sado të shkurtër në gjuhën shqipe, e cila u hodh në letër jo rastësisht prej dorës së tij. Në të kundërtën arqipeshkëv i atëhershëm i Tivarit Imz. Marin Bici mëton zërin e një liliptu sado të zakonshëm, thjesht dhe vetëm se relacioni i tij i vitit 1610 "është një burim historik me interes të madh" (FESH I 94; e - për rrjedhojë e pa ndryshime edhe - në FESH II 243).

Por jo vetëm kaq: Diskriminimi i zhguni dhe veladonit të zi si pjellë e parimit ideologjik damnatio memorie ka shkruar aq larg në FESH I e - për rrjedhojë edhe - në FESH II, sa nuk është marrë fare mundim të hetohet e kumtohet diçka më shumë ndaj martirëve (të parë) të krishtërimit të mirëfillt shqiptar, siç është p.sh. rasti i Imz. Gjon Brunit - Ulqinakut (shk. <Johannes Brunius Olchini>), arqipeshkëv i Tivarit, pjesëmarrës aktiv në Koncilin e njohur Tridentin (1552-3, 1562) dhe i martirizuar dhunshëm prej osmanëve (1571) për shkak të bindjes së tij fetare.

Por jo vetëm kaq, sepse ka edhe më keq: meqë diskriminimi i veladonit të zi si shuarje e kujtesës në FESH I e - për rrjedhojë edhe - në FESH II e kalon lehtës edhe detin në këmbë. E për këtë mjafton të zbresim në brigjet e Sicilisë e të trokasmis në portat e Seminarit (kishtar) Italo-Arbëresh të Palermo/Horës së Arbëreshëve që u themelua atëbotë (1734) jo rastësisht për të formuar priftërinj katolikë të rritit bizantin e si i tillë u shndërrua shpejt edhe në qendrën e parë të njohur të kërkimit kulturor-shkencor albanologjik. Në këtë funksion (të dytë) kanë gjetur vend në FESH I e - për rrjedhojë edhe - në FESH II vetëm ato autoritete të mendimit albanologjik bashkëkohor të rangut të At Nikollë Ketës (= <Padre Nicolò Chetta>) apo lëvruet të shkrimit shqip të rangut të At Nikollë Filjas (= <Padre Nicolò Figlia>), ndërkohë që vetë seminari sikurse edhe vetë themeluesi i kësaj qendre, At Gjergj Guxeta (= <Padre Giorgio Guzzetta>), i mirënjohur atëbotë si Apostulli i Arbëreshëve të Sicilisë, madje i vetmi personalitet i mumifikuar në gjithë botën shqiptare-arbëreshe (!!!), nuk gjen vend në FESH I e - për rrjedhojë edhe - në FESH II; e kjo, pas gjase, për një arsye fare të thjeshtë, fare banale: në periudhën e hartimit të FESH I - e për rrjedhojë edhe në FESH II - kjo figurë kyçe e mendimit intelektual-albanologjik të kohës shihej e fshihej thjesht dhe vetëm si bartës i atij veladoni të zi kishtar, i cili themeloi si i tillë edhe atë seminar, madje për modestinë që karakterizonte vetëm sillojin e vet nuk 'denjoi' të bëhej as rektori i tij i parë, në mënyrë që t'u bënte vend më të rinjë.

Ja që fati ynë fammirë e sollë që roli i At Gjergj Guxetës në ecurinë dhe zhvillimin e kësaj qendre të parë fetare dhe kulturor-shkencore albanologjike - edhe pse njëjsh si e tillë prej shekujsh - të zbulohet faktikisht në dorëshkrimet e tij e të bëhej i njo-

hur për rrethet shkencore albanologjike vetëm në fillimet e mijëvjeçarit të ri, prirudhë kjo gjithsesi më se e mjaftueshme edhe për redaksinë përgjegjëse të FESH II të ndërmerrte diçka me i zbardhur faqen.

A është vërtet kjo 'vonesë' një arsye e fortë që At Gjergj Guxeta të mos përfshihet me një zë (e pse jo të tipit të madh?) në FESH



I e - për rrjedhojë edhe - në FESH II? Kësaj pyetjeje lejohe mi t'i përgjigjemi në të dyja rastet me po!: a) në periudhën kur u hartua FESH I, At Gjergj Guxeta - siç përmendim më lart - njihej thjesht dhe vetëm si bartës i atij veladoni të zi, edhe pse si i tillë kishte themeluar seminarin në fjalë; dhe b) bordi redaksional i FESH II, i zbardhur nga thinjat ishte larg çdo lloj informacioni për 'zbulimin e madh' në shekullin e ri, andaj edhe iu përmbajt me besnikëri aktuar-rëveshjes së heshtur, përkatësisht të (pa)vetëdijshme, të përsiatit më lart prej nesh, në mos - edhe më zi!!! - vijoi të punonte sipas motos: "Te vdekurit të të vdekurit, të gjallët midis të gjallëve!"

3) Por jo vetëm kaq, sepse ka vërtet edhe më zi: raste të këtylla banaliteti të rangut (vetëm ?) enciklopedik shqiptar, që arrinjën pikën më kulmore me heshtjen makabre ndaj 'Nderit të Kombit Shqiptar' në kohën tonë, autorit të "Rrno vetëm për me tregue" (At Zef Pllumi: Tiranë I 1995, II 1997, III 2001; Shkodër 20152), sigurisht që nuk do t'ia vlen të vërtet barra qiranë me i zënë me gojë e me laps, sikur të mos përballëshim në mënyrë ballore me atë mohim, përkatësisht shpërfillje thaujae tërësore të aktivitetit qoftë kulturor-fetar, ashtu edhe të atij shkencor-albanologjik e didaktik në gjuhën shqipe dhe/ose për gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare në përgjithësi, si më i pari që u përfuta brenda hapësirës kompakte shqipfolëse falë ngulmit dhe punës në vazhdimësi të klerit katolik shqiptar e të huaj për periudhën në fjalë, por që nuk gjen vend në FESH I e - për një rrjedhojë edhe - në FESH II; veçse, ndërsa i pari falë bazës ideologjike të paracaktuar dhe përcaktuar nga lart, i dyti falë pavetëdijshme intelektuale si pjellë a rrjedhojë e paragjykimit ideologjik të trashëguar ndaj shpërlarjes së kujtesës.

edhe, madje sidomos, të kesh e të zotërosh sa e sic duhet - thënë me lezet (!!!) - jo më pak se tri palë mend në kokë...

Nuk ka pasur ende reageime, ndërsa interesante është se shjtella në pjesën e dytë të shkrimit është edhe më e ashpër sesa në pjesën e parë.

Redaktori shkroi diçka për një libër të titulluar "Lori Xhimi". Por, është një eveniment ardhja e tij në shqip pasi është një libër i të famshmit Konrad. Një libër i këndshëm, por disi i tejkaluar në shijet e publikut të sotëm. Përkytesi Simoni kishte punuar mirë, kurse PEGI dhe Ministria e Kulturës duhet të vlerësohen për sjelljen e këtij klasiku në shqip, që për hir të vërtetës ka qenë edhe para viteve '90.

Profesor Nasho Jorgaqi në "fiksimin" e tij për haikun na kish propozuar krijimtarinë e një vajze, madje kishte shkruar dhe diçka për të, me shpresën e inkurajimit të poetëve që punojnë në këtë gjini.

Tregimi i Bahri Myftarit përbente një alegori të këndshme të autorit, e përcjelle në formën e një tregimi të mbledhur me kujdes...

Në këtë numër sollëm një intervistë të një autori të huaj danez falë përkytesit Kujtim Morina. "Kur bëhem i verbër" nga poeti danez Niels Hav ka dalë së fundmi në përkytesin holandisht. Ka vite qyshse Hav konsiderohet një poet tërëqës, i përkythyer tashmë në anglisht, italisht, arabisht dhe në gjuhën kineze. Tani, kur poezitë e tij përmes përkyqejeve të përkytesit Jan Baptist na vijnë në format libri në Vendet e Ulëta, ishte kohë e përshatshme për Meander që të bënte këtë intervistë via e-mail me danezin...

Në përgjithësi ishte një numër i mirë, por disi i stërgjatë. Të shohim sesi do të priet, megjithatë feedback-ët ka kohë që mungojnë, kurse vinë janë thjesht ankimtarë dhe bezdisës.

Kështu, nuk mund të justifikojmë dot aspak si harresë apo lajthitje redaksionale të rastit, faktin që Imz. Andrea Bogdani, arqipeshkëv i Kishës Metropolitane të Ohrit nuk gjen fare vend në FESH I, e - për rrjedhojë edhe - në FESH II, edhe pse ka aktivitet të pasur baritor, madje jo vetëm sish, sepse jemi të mirinformuar prej nipit të tij, Bogdani të Madh dora vetë, që ai na kishte lënë atëbotë në dorëshkrim edhe një "gramatikë latin e shqip", e cila "u tret si krypa nd' ujtë", që vjen me thënë si rrjedhojë e neshtrashave të moteve.


Por jo vetëm kaq, sepse ka edhe më zi, përkatësisht edhe më turp, meqë tash nuk kemi përse bëjmë më aspak çudi, përse edhe murgu françeskan albanolog At Francesco Maria da Lecce pëson të njëjtin fat: i mungon një zë i veçantë në FESH I e - për rrjedhojë edhe - në FESH II, edhe pse është autori i gramatikës së parë solide të shqipes që pa dritën e diellit sigurisht në Perëndim (Romë 1714), sikurse edhe autori i një fjalori aspak modest italisht-shqip në dorëshkrim - 1702, që e pa këtë dritë kohë e fundit në Shkodër (Gurga 2009), por që ishte zbuluar e përshkruar qysh në vitet 90-të të shekullit të kaluar.

4) Por jo vetëm kaq, sepse ka edhe shumë më zi, përkatësisht edhe shumë më turp e dhunë. Një situatë akoma më të rëndë e përjetojmë në përmasa vërtet marramendëse - thaujae të tipit të një holokausti intelektual-po-shqiptar ndaj Kishës Katolike-Romake - sidomos në gjysmën e dytë të shek. XIX,

përkatësisht vuanjë në bashku zezonën alla-shqiptarçe të kohëve moderne: përgjithësisht nuk janë përfshirë me një zë të veçantë, qoftë edhe të tipit liliptu në FESH I e - për rrjedhojë edhe - në FESH II.

Irritimi është vërtet i tillë, aq sa nuk mjafton të jesh patjetër qelan, për të përjetuar se si të rriten flokët dhe mjekra vetëm e vetëm për të t'u ngritur qimet përjetë. Sepse nuk ka vërtet asnjë shkas a arsye tjetër me motivuar mungesën, përkatësisht lënien në harresë në FESH I e - për rrjedhojë edhe - në FESH II të gjithë asaj aradhe studiuësish dhe lëvruësish të gjuhës shqipe, sikurse gjithë ata botues seriozë të gramatikave, fjalorëve të kësaj gjuhe, të rangut të P. Francesco Rossi-it, At Jak Junkt (= <P. Giacomo Jungs>), P. Antonio Busetti-it, Don Dodë Kolecit (autor i "Fjaluar i Ri i Bashkimit", Shkodër 1909) a më pas P. Emilio Fulvio Cordignano-s e shumë e shumë e shumë të tjerëve që jetonin dhe vepronin asokohe në hapësirën jetike shqiptare, vetëm e vetëm se ishin 'të damkosur' të jesin në mish e në shpirt me "Thirrjen Hyjnore".

Por jo vetëm kaq e jo vetëm këta: 'Thirrjen' e përjetuan këtë periudhë e më pas shumë e shumë lëvruet të mirëfilltë të kulturës së shkrimit shqip, të tillë si si-arbëreshi At Zef Guagliata SJ (= <P. Giuseppe Ignazio Guagliata>), Vincenzo Basile SJ, P. Adone Aldagheri SJ, Imz. Pashko Babë, At Pashko Bardhi OFM, P. Gjon Luigji Bazhdari, D. Llesh Bitroj, Imz. Dario Bucciarelli OFM, P. Luigi Cattaneo SJ, Imz. Ernest Maria Çoba, P. Daniel Dajani SJ, P. Alessandro Fracchioni SJ, P. Francesco Genovizi SJ, P. Pashko Gjadri SJ, D. Gaspër Gurakuqi, P. Mark Harapi SJ, P. Gjon B. Karma SJ, D. Nikollë Kimza, P. Anton Luli SJ, P. Tommaso Marcozzi da Rapino OFM, P. Paolo Antonio Merlo SJ, P. Pjetër Maria Meshkalla SJ, Imz. Lazër Mjedja, P. Gjon Pantalija SJ, P. Domenico Passi SJ, P. Giovanni Battista della Pietra SJ, At Ndre Logoreci etj., etj., etj. Duken sikur janë shumë, por janë në të vërtetë shumë më shumë, madje edhe më shumë se shumë më shumë, sepse shkruesi i këtyre radhëve u kufizua të citojë këtu vetëm ata autorë të botuar thaujae vetëm në shtypshkronjën e "Zojës së Papërlëme" (Shkodër 1870-1945), pas gjase në më të parën dhe (ende!!!) më jetëgjatën shtëpi botuese në gjuhën shqipe në hapësirën kompakte shqipfolëse, sic cilës i prenë aortën kryesore më të parës me ardhjen në fuqi të regjimit komunist. Për mëshirën e dhimbshme të fatit kjo shtypshkronjë, ndryshe nga autorët e saj, gjen vend në FESH I e - për rrjedhojë edhe - në FESH II, sigurisht jo si zë i veçantë por brenda një zëri të përbashkët: <Shtypshkronja>, ku për këtë shtypshkronjë e njëherësh shtëpi botuese FESH I kumton qunditshëm: "Vetëm më 1870 administra osmane ngriti një shtypshkronjë" në Shkodër dhe lejoi hapjen e një sh. fetare për jezuitët." (f. 1069), ndërsa FESH II sqaron edhe më mjerueshëm: "Në v[itin] 1870, kleri jezuit soll në Shkodër nga Italia një shtypshkronjë që mori emrin "Zoja e Papërlëme", ku u shtypën disa botime fetare në gjuhën shqipe, me alfabet latin." (bl. III, f. 2641). Ndër këto "disa botime fetare" citojmë të jenë botuar deri në vitin 1934: [f.] 20 grammboks, three dictionaries, five Albanian literature textbooks, 10 textbooks of classical and modern languages, 19 scientific textbooks, and six textbooks of history and



bash kur mësojmë se si Shkodra ravijëzon konturet e veta si qendra kryesore urbane në gjithë hapësirën kompakte shqipfolëse e ku përpos qytetit (që gëzonte atëbotë statusin e Protektoratit Kulturor = gjerm. <Kulturschutzprotektorat>) zhvillojnë natyrshëm aktivitetin e vet disa institucione të kulturi, siç ishte p.sh. Urdhri Jezuit dhe Urdhri i Françeskanëve Minorë, çka ndikoi pozitivisht sidomos në zhvillimin e arsimit, sikurse edhe në formimin intelektual e në lëvrimin e kulturës së shkrimit shqip, përkatësisht në nxitjen dhe përkudjesjen e një aktiviteti të mirëfillt shkencor albanologjik në Shkodër, sikurse edhe në ndonjë qendër tjetër urbane të Veriut, si p.sh. Prizreni. Numri i veprimtarëve, d.m.th. i personaliteteve intelektuale të kohës, jo më pak të denjë për një zë në FESH-in tonë mjerran, rritet në fakt mjaft, veçse thaujae të gjithë ndajnë me njëri-tjetrin të njëjtin fat,

→ Vizion nga faqja 21

geography." (I. Murzaku: Catholicism [...] 2006 232)

Më mirë ta mbyllim këtu gjithë këtë periudhë, sepse sigurisht mund të sjellim shembuj edhe më të rëndomtë, që vjen me thënë edhe më turpshëm, edhe më banalë, në rast se vijojmë analizën tonë në këtë pamje aspak të dorës së dytë e të tretë në trashëgiminë e vyer dhe të patundshme të kulturës shqiptare, duke kaluar analizën tonë në gjysmën e parë të fazës në vazhdim (nr. 5: v. 1912-1944) me botimet e radhës në shtypshkronjën françeskanë (1917-1944) si edhe në kontributin e klerikëve intelektualë shqiptarë e të huaj në revistat kulturore të kohës, për shumicën e të cilëve, përpos ndonjë retushimi dhe 'zbulimi' të rasti, edhe në FESH II rëndon ora e heshjtjes, çka përcjell bindshëm organizimin sa të paorganizuar aq edhe të pafan, por të radhës, në qerthullin e bordit redaksional që mori përsipër të ribotojë Fjalorin Enciklopedik Shqiptar.

Asgjëmangut, kjo rrethanë aspak famirë e bën ende më të ngulmët atë pyetje që shtruan më lart lidhur me ndërmarrjen për një ribotim të dytë të FESH-it: Sa ishte e përgatitur vallë Enciklopedia Shqiptare, në mos vetë intelijenca shqiptare dhe shkencat albanologjike me rrjetin infrastrukturor përkatës për t'u përballur me këtë imperativ të kohës? Vëzhgimet paraprake me të dhënat faktike - edhe pse jo të plota - nuk i japin thjeshtë dhe vetëm përgjigje negative kësaj pyetjeje, por e turmirin plotësisht atë përsiatje vërtet tronditëse që përcollim me një kornizë dyshimi më lart: damnatio memoriae si parim ideologjik sa i mirëstuduar aq edhe vrasar të politikën e kulturës dhe të kërkimit shkencor përgjatë gjithë periudhës së diktaturës në Shqipëri që kish të arritur me kohë e ndërkohë - bash kur askush nuk donte dhe kërkonte të identifikojë më me të!!! - një pikë kulmore në syzimin e vet afatgjatë: shuarjen e kujtesës historike-intelektuale, përkatësisht rrënjosjen e thellë dhe të thelluar të mosnjohjes së (pa)vetëdijshme në mendësinë dhe angazhimin social të shtresës intelektuale shqiptare në shumësinë e vet; një proces ky afatgjatë që është sendërtuar me suksesin sa të mirëstuduar (në FESH I), aq edhe të neveritshëm si të tillë në ribotimin e tij (FESH II).

5. 'Teprica' të tepruara ndër fjalët mortore

Duke mbyllur këtu përsiatjen tonë me argumentet pozitive përkatëse lidhur me dukurinë damnatio memoriae, bash me shpëlarjen e kujtesës historike-intelektuale si masë ase dënim dikur i pashkruar për (të paktën) gjithë atë periudhë pesëshkulllore në trashëgiminë e vyer dhe të patundshme të kulturës dhe historisë së popullit shqiptar, fitojmë njëherësh të drejtën legjitime me ngushtuar edhe hapësirën kohore të të ashtuquajturit 'tipar dallues' (prej FESH I), një risi kjo sa cilësore aq edhe sasiore që mëton të paktën bordi redaksional në parathënien e FESH II, të cilën e përcollim të plotë më lart e që "është pasqyrimi i gjerë i personaliteteve e i figurave të historisë kombëtare. [...]". por që rezulton tash të ketë të bëjë natyrshëm vetëm me periudhën në vazhdim, kryesisht në dy fazat e saj të fundit (nr. 7 dhe 8: v. 1984-2008/9).

Asgjëmangut, për këtë periudhë është e kotë të bëhen hamendje deri provokuese të asaj natyre, nëse mund të kishit/ketë ekzistuar ndonjë pakt, përkatësisht një akt-marrëveshje e heshtur - për të qenë më të saktë! - për 72 vitet në vazhdim, pra deri më 1984, kur FESH I mbylli siparët e vet me gjithë-gjithë 114 zëra persona (litete)sh (f. 1-335: A-G-J), ndërkohë që FESH II - siç e kërkonte apo e detyronte vendi dhe koha - i hap i dyfish të vetët me 241 syresh (bl. I, A-G-J). Veçse po të vazhdojmë ndërkohë të ecim në po këtë hulli gjykimi për fazën në vazhdim, d.m.th. pas vitit 1984 (deri më 2008/9), të cilën FESH II (bl. I: A-G-J) e përfaqëson me plot 387 zëra - ndër ta madje 224 persona gjëllinim atëbotë a jesin ende sot midis nesh - lejohej të s'zyzojmë tani pa hezituar aspak që ky 'tipar dallues', i anoncur në par-

athënie, hedh shtat e merr formë të plotë shi gjatë fazës së dhimbshme "tranzicionit" në jetën politike e sociale-kulturore në Shqipëri, së cilës edhe sot nuk i dihet fundi, por që fiton domethënie të madhe bash për atë dukuri të dytë që e kemi cilësuar si laudatio funebris: lëvdatë në formën e fjalës mortore, të cilën përjeton dhe zhvillon tashmë vetëdijshëm vetëm në dhe për këtë fazë bordi redaksional i Enciklopedisë Shqiptare.

Këmbëngulim fort në këtë konstatim, duke iu referuar (vetëm ?) bordit redaksional të FESH II, ani duke mos dashur asesi të këllasim sytë e hundët në hejbet e gjithë asaj shtrese intelektuale shqiptare të regjistruar ndërkohë në këtë Fjalor, edhe pse faktet mëtojnë që jo pak pinjollë të saj kanë pasur rastin, fatin dhe mundësinë të çepkasin dhe shijojnë për së gjalli e me mirëkuptim në grup zërin e tyre enciklopedik si lëvdatë të vet ndaj vetvetes gysht gjatë përgatitjes së këtij botimi. Dhe është fakt që prej inventarit të personelit drejtues, realizues dhe redaksional të FESH II (Tiranë 2008/9) prej jo më pak se 168 anëtarësh, plot 124 sosh (= 73.8%) i kanë lejuar dhe mundësuar vetes (jo) më kot përfaqësimin në Fjal-



...dhe shpëlarja e kujtesës historike-intelektuale

orin Enciklopedik Shqiptar me një zë të veçantë kryesisht të tipit të mesëm dhe padyshim e sigurisht - siç theksohet edhe në parathënie! - si "personalitete e figura të historisë kombëtare shqiptare". Kuota e përqindjes rritet gjithsesi në proporcion të drejtë me ngjitjen e shkallëve të infrastrukturës dhe hierarkisë organizative: Kështu p.sh. në bordin e Redaksisë së Përgjithshme me plot 47 anëtarë vetëm 3 syresh nuk janë përfshirë me një zë të veçantë në FESH II, pra kemi një kuota të 93,6%; përndryshe Këshilli Drejtues me 7 anëtarë ngadhënjën kuota optimale me 100%, sikurse edhe vendi i hudhrës, bash ai i Redaktorit të Përgjithshëm që e mbulon i vetëm dhe krenar filologu ynë, Emil Lafa dora vetë. Parë nga kjo perspektivë shprehim pa kurrfarë mëdysheje bindjen tonë, madje duke vënë edhe dorën në zjarr, mbi gur a gjetkë, që FESH II vështirë të ndeshë dikur a diku konkurrencë ndër fjalorë dhe enciklopedi kombëtare jashtë hapësirës kompakte shqipfolëse, duke mëtur në kohë dhe hapësirë e me distancë të konsiderueshme, vendin e parë e të përjetshëm në Guinness World Records.

Deliri i madhësisë dhe kompleksi i inferioritetit

Janë bash këto pamje të injorancës që vuan njëherësh delirin e madhësisë dhe kompleksin e inferioritetit, të cilat shoqërojnë pasqyrimin e emrave të injorantëve me birë dhe fshëhin pasqyrimin e personaliteteve në Enciklopedinë Shqiptare, duke sendërtuar së bashku ato dy dukuri tejet negative në diskursin e sotëm intelektual shqiptar: laudatio funebris vs. damnatio memoriae, dy dukuri që derdhen së bashku helm dhe bërllog intelektual në procesin sa regresiv aq edhe agresiv të 'Emilimizimit' të Enciklopedisë Shqiptare.

Të vjen njëherësh për të qarë e për të qeshur kur përballësh me një rrethanë të tillë tragjikomike që përcjellin faktet vërtet tronditëse, të cilat në thelb nuk i ndryshojnë aspak drejtimin pyetjeje që shtruan në hyrje të këtij punimi e që patëm rast ta përsërisnim disa paragrafë më lart: Sa ishte e përgatitur vallë Enciklopedia Shqiptare, në mos vetë intelijenca shqiptare dhe shkencat albanologjike me rrjetin infrastrukturor përkatës për t'u përballur me këtë imperativ të kohës? Kjo pyetje degëzohet sigurisht në detaj e në varësi me shtimin e shoqësimin intelektual: Cfarë (para)kupton mirëfilli bordi redaksional drejtues i Enciklopedisë Shqiptare në platformën e vet me konceptin "personalitete dhe figura të historisë kombëtare"? Kur, siç mësojmë të paktën prej FGJSSH (Tiranë 1981), me të kuptojmë ende në përdorim të dytë figurativ: "Njeri shumë i rëndësishëm a i shquar në një fushë të caktuar të veprimtarisë politike, shoqërore, ushtarake, shkencore etj. Personalitet politik. Personalitet i shquar (i dëgjuar)." (f. 1404); dhe për këtë përdorim është a duhet të jetë pas gjase fjala edhe në FESH II. E për t'u bërë tash edhe më konkretë: Cila instancë dhe cili institucion

masat e kësaj ndeshtrashe ogurzeze, sidomos të zhbrirojë qoftë edhe ato përjetime të para të njërit apo tjetrit intelektual, në mos koleg albanolog të gjallë - e këta janë (ende) shumë!!! - që ka pasur fatin të lexojë, në mos të redaktojë po vetë, lëvdatën e vet si fjalë të vet mortore ndaj personit të vet. Po t'u shtëmangemi bisedave thjesht private, të zhvilluara kohë pas kohe e rast pas rasti me dikë që nuk e ka ndërjetë veten mirë, kur ka lexuar këtë lëvdatë në FESH II, dallojmë këtu vetëm njërin që ka mbajtur qëndrim negativ në mjediset publike, siç është rasti i prof. David Lukës ("Mapo" 04.05.2011), i cili mëngon të ngrejë zërin me një stil sa elastik aq edhe sarkastik, meqë numri i kolanës së tij "Gjurmime gjuhësore" dhe i monografive të tjera ishte rritur dukshëm në periudhën ndërmjetëse midis fazës përgatitore dhe botimit përfundimtar të FESH II, andaj edhe nuk kish si të gjente vend gjithçka në të. Për më tepër ai nuk mungon të përdorë as bodecin ndaj bordit redaksional që është treguar aq dorlëshuar, duke shtënë në fjalësinë e zërave enciklopedikë me kuç e me maç emra personaliteteve dhe figurash të gjalla historike.

Ndër ata të njohur - asesi koleg!!! - që kemi pasur fatin aspak fatlum t'i lexojmë në portalët e internetit është filologu në pension prof. Emil Lafa në kumesën e përmendur më lart, ku përpos fishekzjarreve që prodhon në tabakanen e vet, e të cilat i ndez e i hedh pa hesap e pa sqmë lidhur me realizimin dhe botimin e FESH II, mëngon të citojë pa thonjëza pasazhe të tëra, të marra thuajse të gatshme prej parathënies së këtij botimi, çka lë të kuptohet me dashamirësi se është bash ky ai dikushi edhe hartuesi, më saktë, kompiluesi i asaj parathënieje.

Në rast se lejohej të marrim tash në analizë 'personalitetin' e këtij personi, lindur në Vitthkuq (< shek. XIX: "Bythakuqe") më 1938, që jeton ende e që përfaqësohet në FESH II me zë të veçantë të tipit të mesëm (bl. II, f. 1448 v. - plot 40 rreshta e, për arsye pas gjase thjesht teknike pa fotografi bardh-e-zj), e ndërmarrim këtë hap falë sta-

tusit të tij multifunksional në rrjetin infrastrukturor organizativ të vetë FESH II, ku mbulon sipas vendit dhe rasti gjashtë pozicione, si p.sh.: a) anëtar i Këshillit Drejtues (f. V); b) Redaktor i Përgjithshëm (f. VI); c) drejtues i Qendrës Enciklopedike Shqiptare (v. 1999-2008); d) bashkëredaktor shkencor për fushat: Letërsia dhe Gjuhsia (f. VII); e) anëtar i Redaksisë së Përgjithshme (f. IX) si edhe f) pjesëtar i Redaksisë së veçantë të Gjuhësisë (f. XI). Sigurisht që të gjitha këto funksione nuk i hyjnë as atij vetë në sy, në rast se marrim në vështrim ato të tjerat, me të cilat këndon si fjalë mortore zërin e vet të veçantë në FESH II. Bëjmë fjalë këtu për punën dhe karrierën e tij profesionale thjesht dhe vetëm për të fituar bukën e gojës: a) si pjesëtar në disa komisione projektsh gjuhësore brenda kuadrin të aktiviteteve të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë - IGJL); ndër to feks sidomos të qenët e tij anëtar i komisionit organizues dhe delegat në Kongresin e Drejtshkrimit (Tiranë 1972); b) disa kohë si përgjegjës i sektorit të Kulturës së Gjuhës dhe të Terminologjisë (IGJL) dhe c) prej vitit 1993 si kryeredaktor i revistës ndërkohë fantazmë "Gjuha Jonë"; e si gjithëherë d) vetëm bashkëautor në disa botime të natyrës akademike, si edhe i ndonjë botimi kompilues pa kurrfarë vlere shkencore të spikatur, përkatësisht pa shtyllë kurriore të vetën (khs.: E. Lafa & Nikoleta Cikuli: "Fjalor i emrave gjeografikë gjeografikë të Republikës së Shqipërisë" Tiranë 2002; "Persizmat në gjuhën shqipe [...] (të nxjerra nga fjalori i Dizdorit) Tiranë



BOTIM

*Që unë të dua, madje nganjëherë edhe më shumë se ç' duhet, ti e di mirë: motivi është se jam xheloz për mençurinë tënde. Ah kjo plaka e çmendur, mençuria!
Po të të braktiste ndonjëherë mençuria, ah, atëherë do të të braktiste edhe dashuria ime!"
Në këtë pikë jeta vështroi mbrapa dhe përreth vetes dhe më tha me zë të ulët: "O Zarathustra, ti nuk je besniku im aq sa duhet!"*

KENGA E DYTE E VALLEZIMIT

NGA FRIDRIH NIÇE*

1.
"Dje të vështrova në sy, o jetë: tani i pashë të vezullonë syrin tënd të errët si nata, -dhe zemra m'u ndal nga lakmia:
-pashë mbi ujërat mbrëmësore një barkë të artë vezulluese, një guackë të artë, që zhytej, pinte, thërriste, lëkundej!
Këmbës sime, çmendisë së saj të vallëzimit, një vështrim i hodha, një vështrim që qesh, pyet, lëkundet dhe harxhon:
Vetëm dy herë me doçka preka zilkat e tua dhe këmba kish kohë që më dridhej nga padurimi i çmendur për vallëzim:-
U ngritën takat, gishtat ungrehën në përgjim, për të të kapur: valltarinë gishta ka veshë!
Kërceva drejt teje dhe ti u tërhoqe duke i kur kërcimit tim; dhe drejt meje gjuhëtoi krifa jote arratisëse, valavitëse!
Kërceva larg teje dhe gjarpërinje të tu: dhe tashmë ti palëvizur rrije, e gjysmëkthyer, syri plot dëshirë.
Me vështrime të përkulura- më mësove rrugët lakore; mbi rrugët lakore këmba ime i mëson-ligësitë!
Të frikësohem kur afroresh, të dashuroj kur largohesh; ikja jote më tërheq, kërkesa jote më ndal: vuaj, por për ty gjithçka do të vuaja!
Ti je ajo, që me akull ndez, që me urrëjtje josh, që me arratisje burgos, që me përcjnim-

prek:
- e kush s'do të të urrente, o prangosëse, dredhëse, tunduese, kërkuese, zbuluese e madhe!
E kush nuk do të të deshte, o mëkatore e paduruar e vullshme si era, me sy të pafajshëm!
Ku po më zvarrit tani, o e lëshuar, o e shfrenuar? Dhe tani përsëri më braktis, ti mosmirënjohëse e ëmbël rebele!
Po të ndjek duke vallëzuar, po të ndjek edhe kur gjurmët shuhen. Ku je? Ma jep dorën! Ose të paktën një gisht!
Ja shpellat, gëmushat e dendura, po humbim!-Ndal! Ndalo! A nuk i shen të flurojnë bufat dhe lakuriqët?
Ti je bufe! Ti, lakuriqe! Po ma dredh prapë? Ku jemi? Nga qentë kam mësurat të ulurij dhe kujis kështu.
Me hir më tregon dhëmbët e bardhë, sytë e tu të ligj më sulen përmes jeles tënde të kaçurreltë!
Ky është një vallëzim që tejkalon gropa e gurishte: unë jam gjuetar- a do të bëhesh qeni im dhe kastori im?
Shpejt, hajde pranë meje! E shkathët, e ligë, me kërcimet e tua! Tani këtu lart! Tani, nga ana tjetër! - Sa keq! Tani jam unë ai që po bie duke kërcyer!
Tani më shih të shtrirë, ti o krenari, o hir përulës! Sa qejf të shkonim bashkë shtigjeve të lumtura!



- Shtegu i dashurisë nëpër gëmusha me-mece e të larme! Ose atje tej, gjatë bregut të liqenit: atje notojnë e vallëzojnë peshq të artë!
U lodhe tani? Ja, atje poshtë ka dele dhe perëndime djelli: a nuk të pëlqen të flesh kur barinjët fyellit i bien?
Kaq shumë u lodhe? Do të të shpie poshtë, vetëm lësho krahët! Dhe po qe se ke etje, kam diçka por goja jote nuk do ta pijë!
-Oh ky gjarpëri me nyje i shkathët e i mallkuar, shtrigan që çvesh dorë! Ku humbe? Po mbi fytyrë i ndjek dy lunga dhe njolla të kuqe

që më la dora jote!
Vërtet që jam i lodhur nga zanati i bariut për ty, i ndrojtur si një qingj! O shtrigë, deri tani këndova unë për ty tani je ti që duhet të bërtasësh për mua!
Me ritmin e kamxhikut tim duhet të vallëzosh dhe të bërtasësh! Nuk e kam harruar kamxhikun?-Jo!"
2.
Atëherë ja sesi m'u përgjegji jeta duke mbyllur veshët hirëplotë:
"O Zarathustra! Mos e përplas aq mmer-shëm kamxhikun! Ti e di mirë: zhurma i vret mendimet, -dhe pikërisht tani po më vijnë mendimet më të ëmbela.
Ti edhe unë s'dijmë të bëjmë as të mirën dhe as të keqen. Përtej të mirës dhe të keqes e gjetëm ishullin tonë dhe kopshtin tonë të blertë-vetëm ne të dy! Edhe vetëm për këtë ne duhet ta duam njëri-tjetrin!
Edhe po qe se s'e duam me një dashuri të thellë-mos duhet ta marrim për keq dashurinë e cekët?
Që unë të dua, madje nganjëherë edhe më shumë se ç' duhet, ti e di mirë: motive është se jam xheloz për mençurinë tënde. Ah kjo plaka e çmendur, mençuria!
Po të të braktiste ndonjëherë mençuria, ah, atëherë don të të braktiste edhe dashuria ime!"
Në këtë pikë jeta vështroi mbrapa dhe përreth vetes dhe më tha me zë të ulët: "O Zarathustra, ti nuk je besniku im aqsa duhet!"
Ti më do shumë më pak se sa thua; unë e di, ti mendon se, së shpejti, do të më lësh!
Ekziston një këmbanë e vjetër shumë e rëndë me tingull tepër kumbues: nata e kumbimit të saj ngjitet deri këtu lart në shpellën tënde:-
-kur të dëgjosh këmbanën të bjerë për mesnatën, ndërmjet nëshit dhe dymbëdhjetës mendo për këtë
-për këtë mendo, o Zarathustra, unë e di, mendo që shpejt do të më lësh!"
"Po" u përgjigja, hezitues, "por edhe ti e di -" Dhe i thashë diçka në vesh, mes kaçurrelave të saj të çmendura, të çrregullta e të verdhra.
" E di ti këtë, o Zarathustra? Askush nuk e di"
Dhe e vështrua njëri-tjetrin dhe pastaj vështruam kopshtin e blertë, mbi të cilin ndërkaq kalonte mbremja e freskët dhe qamë të dy bashkë. -Atëherë jeta u bë për mua më e shtrenjë se e gjithë mençuria ime. -
Kështu foli Zarathustra.

2010); madje d) mëton të ketë qenë specializuar edhe në Universitetin e Bonn-it si burisist i "Fundacionit Alexander von Humboldt", edhe pse shumëkush që e njeh nga afër e di fort mirë që këtë bursë ai nuk e fitoi aspak me dërsë, mund dhe aftësi si shkencëtar i ri e premtes në biologji, por iu akordua nga lart në moshë të thyer dhe për arsye të koniunkturës politike të kohës, përkatësisht në fund të viteve 80-të (shek. XX) në kuadrin e normalizimit të marrëdhënieve diplomatike midis RPSH dhe FRFGJ. Projekti i tij i përcjeshëm më saktë 'Gioconda' e tij, për të cilin mori edhe rrugët drejt Bonn-it: Lidhëzat në "Me-sharin" e Gjon Buzukut ishte sigurisht i paracaktuar dhe i përcaktuar të dëshantonte si gjithëherë me sukses, andaj edhe nuk e ka parë ende dritën e diellit si botim monografik me vetëm një autor.
Por jo vetëm kaq: Në një botim të tretë të FESH-it, në rast se ky emër do të na shfaqet për fatin tonë të pafat rihatas si zë i veçantë në kantonin enciklopedik të profesorëve shqiptarë - ritmi i prodhimit të të cilëve të nxjerr (deri) sot vërtet mallin e motos së dikurshme ushtarake: "Gjithmonë me vrap, rrallëherë me hap të shpejtë dhe asnjëherë me hap!" -, do shtuar edhe atributi i tij më i fundit si pjesëtar i triumviratit që drejton organizatën famëkeqe e deri vonë masonike "Shoqata e Gjuhëtarëve Shqiptarë" me një turrë strehsash të pagdhundur e të pagdhendshëm, të cilët, pasi krijuan celulat e mbrojtjes dhe të sulmit në disa qendra urbane të hapësirës kompakte shqipfolëse, kanë dalë ndërkohë nga ilegali-teti (11 korrik 2014), duke pasur si ideal dhe qëllim të devotshëm minimin nga brenda dhe jashtë, përkatësisht shkaterërimin me çdo kusht e mjet të çdo lloj përpjekjeje famirë që ndërmer Këshilli Ndërkademi-k-sidomos sosh të akademikeve të Kosovës (!!!) - për përkudjesjen dhe përmirësimin e normës gjuhësore të të ashtuquajturit Standard, edhe pse nuk u del kurrë nga shpirti e zemra, sikurse gjithmonë në ëndërr emërtimi i mëhershëm me katër mbiemra: Gjuha letrare kombëtare e njësuar shqipe.

A gëzojnë vërtet njerëz të këtillë, që gjëlljnë ende në këtë botë me kaq dhe aq funksione - si pjesë e punës dhe e karrierës së tyre profesionale thjesht dhe vetëm për të fituar bukën e gojës - automatikisht edhe të drejtën për t'u përfaqësuar me një zë të veçantë në FESH si "personalitete a figura të historisë kombëtare", d.m.th. si pjesë e trashëgimisë kulturore-historike të vyer e të patundshme të kombit shqiptar? Apo mos kemi të bëjmë vallë bash në këtë periudhë 'tranzicioni' shoqëror me një shpërdorim ase abuzim më se të zakonshëm, por këtë radhë në grup (!!!), që vjen me thënë me një sfaqje korruptivni në mos kriminaliteti intelektual, por në grup (!!!), që bart si i tillë përmasat e një unikati të paskrupull e të pashoq në gjithë historinë e kulturës shqiptare dhe të shkencave albanologjike? Janë këto përslatje thjesht dhe vetëm degëzime në detaj të pyetjeve thelbësore që ngrihen dhe përsëritem disa herë në këtë shkri-m: Sa ishte e përgatitur vallë Enciklopedia Shqiptare, në mos vetë inteligjenca shqiptare dhe shkencat albanologjike me rrejetin infrastrukturor përkatës për t'u përballur me këtë imperativ të kohës? Dhe rezultati këtë radhë është edhe më tronditës, sepse procesi i turpshëm laudatio funebris ka marrë në FESH II përmasat e një orgjie të natyrës sodomike, të cilën e ka nxitur (pa)vetëdijshëm bordi redaksional i Enciklopedisë Shqiptare duke joshur, rrokur, qafuar, zhveshur e dhunuar në grup të gjallë e të vdekur, duke nisur së pari me dhe për vetveten.
6. Facit
Injoranca si e tillë nuk ka brirë; janë një turrë intelektualësh funksionarë injorantë që vuajnë sipas rastit delirin e madhësitë dhe kompleksin e theksuar të inferioritetit e si të tillë i vënë vetes syresh vetëm e vetëm për t'u distancuar brenda llojit e për të ngadhënjyer e dhunuar funksione organizative. Duke mbajtur të tillë ata synojnë të shtien e të nxisin respekt dhe përulje ndaj vetvetes në formën e lajkës dhe zillisë si balancë ndaj dhunës strukturale informale. Injoranca nuk njihë sistem shoqëror; ish-

te dikur regjimi politik me bazën e vet ideologjike në Shqipërinë e gjysmës së dytë të shek. XX që u rrek të orientonte njëanshem formimin intelektual shqiptar; thjesht dhe vetëm me syzimin largvajtës për të krijuar njeriun e ri intelektual me injorancë të thellë e të pashembullit kulturor-historike si bartës i një ideali të ri po aq injorues, sa të paudhë aq edhe dësh-tak ndaj jetës dhe historisë së kulturës shqiptare. Produkt i këtij procesi afatgjatë nuk është assesi elita e mirëfilltë intelektuale shqiptare dhe sot, por thjesht dhe vetëm funksionarët e saj injorantë, të djeshëm dhe të sotëm, të cilët kishin e kanë ende nevojë për ketë elitë, sa kohë që gënjenin e gënjëjnë veten se nuk u binte dhe u bie në kundërshti me pozicionin që kishin e kanë dhe funksionet që gëzonin e gëzojnë së gjalli e së vdekur.
Injoranca nuk njihë 'tranzicion' shoqëror; janë injorantët me brirë ata që shfrytëzojnë momente të këtilla për të mbijetuar në kohë dhe hapësirë, duke e vështirësuar (pa)vetëdijshëm këtë proces, madje edhe më zi, duke demoralizuar dhe sakatuar gjithë sistemin e formimit shkencor-universitar në vend.
Janë bash këto pamje të injorancës që vuan njëherësh delirin e madhësitë dhe kompleksin e inferioritetit, të cilat sho-qërojnë pasqyrimin e emrave të injorantëve me brirë dhe fshëhim pasqyrimin personaliteteve në Enciklopedinë Shqiptare, duke sendërtuar së bashku ato dy dukuri tejet negative të diskursin e sotëm intelektual shqiptar: laudatio funebris vs. damnatio memoriae, dy dukuri që derdhin së bashku helm dhe bërlog intelektual në procesin sa regresiv aq edhe agresiv të 'Emilizimit' të Enciklopedisë Shqiptare. A do të vazhdojë ky proces të mbijetojë edhe pas 25 vjetësh (në FESH III? - profeci e filologut në pension E. Lafa), është kjo një çështje motesh, për të cilën shkruasi i këtyre radhëve nuk është i aftë e nuk do të jetë dikur aspak në gjendje të kërkojë, të gjejë e të kumtojë recetat e rastit, përpos të përsërisë maksimumin e mëshumësenjëkuptimshme: "Rrno vetëm për me tregue!" (At Zef Pllumi)

3.
Një
Dëgjo! O njeri!
Dy
Çfarë thotë mesnata e thellë?
Tre
Flija, flija,
Katër
Nga një gjumë i thellë u zgjova:-
Pesë
Bota është e thellë
Gjashtë
Më e thellë se ç'e mendonte dita.
Shtatë
E thellë është e keqja që ka
Tetë
Kënaqësia- më e thellë se dhimbja
Nëntë
E keqja thotë : Kalo!
hjetë
Por çdo kënaqësi do përjetësi
Njëmbëdhjetë
- do përjetësi të thellë, të thellë!"
Dymbëdhjetë

Vjion
*Përktheu Lluka Qafoku